



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 481/1 prot.

Tiranë, më 07.06.2018

VENDIM

Nr. 61, datë 07.06.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 40, DATË 02.05.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 40, datë 02.05.2018 “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****”, protokolluar me nr. 18 prot., datë 12.01.2018”, në Bashkinë Tiranë (Njësia Administrative Nr. 2),

KONSTATOVA SE:

Bazuar në kërkesën/informacionin e paraqitur nga punonjësja ***** me detyrë “Përgjegjëse” në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Njësia Administrative nr.2, Bashkia Tiranë, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 18 prot., datë 12.01.2018, me anë të së cilës pretendon se ndaj saj nuk është zbatuar procedura gjatë marrjes së masës disiplinore “Vërejtje”, Komisioneri filloi hetimin administrativ për këtë rast. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 40, datë 02.05.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****”, protokolluar me nr. 18 prot., datë 12.01.2018”, në të cilin është vendosur:

1. Për rregullimin e paligjshmërisë së këtij veprimi administrativ, Kryetari i Bashkisë Tiranë, duhet të konstatojë si një akt absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 58, datë 05.01.2018, të Administratorit të Njesisë Administrative

*nr. 2, të Bashkisë Tiranë, për marrjen e masës disiplinore “Masë disiplinore vërejtje”, ndaj nëpunëses *****.*

- 2. Njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të fshijë masën disiplinore nga dosja personale e nëpunëses ***** dhe nga regjistri përkatës.*
- 3. Për të rregulluar situatën në lidhje me funksionin e eprorit direkt, të nëpunësve civilë që ushtrojnë detyrën në njësitë administrative, njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionerit, duhet të marrë masa për të përcaktuar skemën e funksionimit të shërbimit civil në njësitë administrative që janë pjesë e strukturës së bashkisë.*
- 4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 40, datë 02.05.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****”, protokolluar me nr. 18 prot., datë 12.01.2018”, të Komisionerit, Bashkia Tiranë me shkresën nr. 17533/3 prot., datë 14.05.2018, “Kthim përgjigje”, ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Në zbatim të pikave 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Bashkia Tiranë ka përcjellë Urdhrin Nr. 17533/2, datë 14.05.2018, “Për anulimin e aktit administrativ nr. 58 prot., datë 05.01.2018, të Administratorit të NJ.A. nr. 2, si dhe fshirjen e masës disiplinore “Vërejtje”, dhënë ndaj *****”, të Kryetarit të Bashkisë, si një akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mungesës së kompetencës së Administratorit të Njësisë Administrative Nr. 2 dhe mosrespektimit të procedurave të parashikuara nga nenet 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut I, pika 13 të Vendimit Nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Në pikën 3 të vendimit objekt verifikimi, Komisioneri, ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, që në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për rregullimin e situatës në lidhje me funksionin e eprorit direkt, të nëpunësve civilë që ushtrojnë detyrën në njësitë administrative, në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionerit, të

marrë masa për të përcaktuar skemën e funksionimit të shërbimit civil në njësitë administrative pjesë e strukturës së bashkisë.

Rekomandimi i mësipërm ka natyrë të përgjithshme dhe, për këtë arsye, çmoj të nevojshme të theksoj se ai nuk cenon ekzekutimin e këtij vendimi. Ai duhet të kihet parasysh nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit me qëllim që në të ardhmen të mos përsëriten më raste të ngjashme, ku roli i eprorit direkt për nëpunësit civilë të njësive administrative, në mënyrë të gabuar, ushtrohet nga Administratori i njësisë.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit, Bashkia Tiranë, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 40, datë 02.05.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 18 prot., datë 12.01.2018”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 40, datë 02.05.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 18 prot., datë 12.01.2018”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Bashkia Tiranë (Njësia Administrative Nr. 2), duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 40, datë 02.05.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Tiranë dhe ankuesja *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha